



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e komitetit për politikë dhe financa (KPF), e mbajtur më **19.10.2022**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal dhe të gjithë ju të pranishëm.

Faleminderit shumë për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 9-të të komitetit për politikë dhe financa.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite me gjithsej 13 pika;

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private për interes publik;
3. Shqyrtimi i projekt statutit të QKMF-së;
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare nga buxheti i vitit 2022;
5. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e projekt planit për trashëgimi kulturore 2022-2025;
6. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2027;
8. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e programit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025
9. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar – shtator 2022;
10. Informatë për përgatitjen e vitit shkollor nga DKA-ja 2022/2023;
11. Shqyrtimi i raportit të performances komunale për vitin 2021;
12. Shqyrtimi i raportit të zyrës së Auditimit të brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimt;
13. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – Ky është rendi i ditës i përgatitur për mbledhjen e sotme. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë vërejtje apo ndonjë propozim shtesë për këtë rendi dite. Nëse jo, atëherë po e vendosim miratimin e rendit të ditës si të tillë. Kush është për?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - Dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe procesverbali nga mbledhja e kaluar.

### **2. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private për interes publik;**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së, para jush e keni propozimin e kryetarit të komunës sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovoës për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës publike me pronë private, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec për parcelën shtetërore nr. 2186-0, prej pjesës së përgjithshme i merren 64m katror dhe i jepet në pronësi pronarit Sylejman Halit Durguti nga sipërfaqja e përgjithshme prej 32 ari e 5m katror, i merret për hapje të rrugës pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 64m katror i jepet komunës së Rahovecit. Të dy parcelat janë në të njëjtën zonë kadastrale në Rahovec. Qëllimi i këmbimit është hapja e rrugës, drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër do të kujdeset në të ardhmen që të rregulloj vijat kufitare ndërmjet dy parcelave. Këto dy parcela sipas PZHK-së bëjnë pjesë në zonën ndërtimore. Ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë propozim vendim për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës publike me pronë private për hapje të rrugës.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë gjë për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë të votave aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

### **3. Shqyrtimi i Projekt Statutit të QKMF-së;**

**Saranda Sallteku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Para jush keni draft – statutin e QKMF-së. Pas debateve dhe daljes në dëgjime publike, të hartuara nga komisioni për hartim të statutit të formuar me vendim të kryetarit. Statuti i QKMF-së është unik i miratuar nga ministria e shëndetësisë për të gjitha komunat e republikës së Kosovës. Gjatë hartimit të statutit janë bërë disa ndryshime shumë të vogla në statutin unik. Ju ftoj që ta miratoni këtë statut.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, kolegë, anëtarë të KPF-së, nënkryetar, ekzekutiv. Unë edhe në herën fundit kur është diskutuar statuti i QKMF-së i kam dhënë vërejtjet pothuajse të njëjta, një pjesë e tyre faktikisht kanë ndryshuar, pjesa tjetër ka mbetur e njëjta. Në statut, drejtoreshë, nuk është i precizuar statusi i maternitetit. Mbetet vetëm një nen ose një paragraf i nenit, ku thuhet; që përshkruhet vetëm atë që e thotë udhëzimi administrativ dhe thotë; aty ku ka shërbime të maternitetit funksionojnë, te ne ka. Duhet të specifikohet edhe te organizimi me qenë funksional materniteti edhe te stafi mjekësor të përcaktohet që është gjinekologu, pediatri d.m.th të jenë pozicionet e specifikuar. Kjo është si vërejtje që e kam. E dyta, është te çështja e organizimit, nuk e di a janë të shumta procedurat e prokurimit në QKMF, që të ketë zyre të prokurimit, prandaj e shoh të paarsyeshme të jetë sepse janë 2-3 procedura të rregullta; Çështja e furnizimit, e mirëmbajtjes dhe ndonjë investim eventuale kohë pas kohe. Një gabim te neni 14, paragrafi 4; Procedurën për zgjedhjen e zv.drejtorit e udhëheq drejtorja komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Kjo çështje duhet me qenë e drejtorit, sepse ka të bëjë me procedurat për emërimin e drejtorit. Është gabim teknik fjala zëvendës i drejtorit. Te pjesa e mjekut të mjekësisë familjare, drejtoreshë unë i kam thënë edhe drejtorit në seancën e fundit kur është diskutuar statuti, nuk e di nëse ekziston ndonjë certifikatë për përdorimin e ultrazërit. Këtu thotë; Mjeku i mjekësisë familjare duhet të jetë i certifikuar për përdorimin e ultrazërit. Ultrazërin e mësojnë në studime (sa kam informacion sepse i kam pyetur mjekët – profesionistët e fushës) dhe një certifikatë që mund ta marrësh në ndonjë vend privat dhe nuk të certifikon

oda e mjekëve që i bie të jetë dokument jo valid në kuptimin institucional. Në çoftëse vendoset kjo, atëherë të gjithë mjekët hiqen nga puna. Duhet të jemi të kujdesshëm që një veprim që kalon sot, mos të jetë me pasoja nesër. **Kryesuesi** – Faleminderit Burim. Me mundësi, herën tjetër për një diskutim të tillë, të precizohet faqja dhe neni dhe të jemi në dijeni të referohemi direkt te ajo pjesë dhe të jemi në ngjarje në atë që po diskutohet. Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për aprovimin e kësaj pike?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tretë e rendit të ditës.

#### **4. Shqyrtimi i propozim vendimit për ridestininimin e mjeteve financiare nga buxheti i vitit 2022;**

**Afrim Limani** – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së. Para juve e keni një propozim për ridestininimin e mjeteve financiare. Duke i bazuar në ligjin e financave publike dhe përgjegjësi, kryesisht neni 30, e kemi shfrytëzuar këtë nen për shkak të natyrës së projekteve dhe specifikave të tjera kemi konstatuar se këto projekte rrezikohen të kalojnë në suficit dhe atëherë kemi shfrytëzuar mundësinë për ta përdorur këtë proces dhe kemi bërë një plan të shpërndarjes së këtyre mjeteve duke u ridestinuuar në kuadër të projekteve të ndryshme. Shuma e mjeteve të parapara për ridestininim është 175.608, kryesisht në kuadër të 4 drejtorive; Drejtoria e shërbimeve publike, ekonomi – turizëm, urbanizëm dhe arsim. Investimi i zonës ekonomike në Optrushë, e kemi një shumë prej 30.000euro që e kemi menduar ta bartim në projekte me donatorë. Kjo pjesë e mjeteve është si rezultat i krijimit të një marrëveshje që e kemi bërë me ministrinë e industrisë dhe tregtisë, ata plotësisht e financojnë projektin dhe detyrë e jona është të investojmë në pjesën e hartimit të projekteve. Në këtë projekt të planifikuar kemi patur 60.000euro, 30.000 janë ndarë për ridestininim, ndërsa pjesa tjetër për hartimin e projekteve. Në investime në turizëm dhe shtigje të ecjes është një shumë e mjeteve e cila ka mbetur si rezultat i mungesës të ndonjë projekti adekuat brenda këtij viti për t'i shfrytëzuar këto mjete të cilat janë bartur në projekte me donatorë, projekt ky që kemi shumë marrëveshje të nënshkruara me partnerë të ndryshëm. Në urbanizëm kanë ngeluar pa u realizuar edhe 30.000euro dhe ne kemi menduar që këto mjete t'i bartin në mallra dhe shërbime. Në arsim e kemi ndërtimin e shkollës në Retijë 31.987euro, ky projekt ka qenë i buxhetuar me kohë, mirëpo vitin e kaluar operatori në fjalë e ka bërë një padi, ose përmes zyrës së thesarit janë tërhequr mjetet dhe pjesa e buxhetuar që e kemi planifikuar në kuadër të këtij projekti ka ngeluar dhe si rezultat i kësaj janë krijuar mundësitë që edhe ky projekt të ridestinohet. Te riparimi në shkolla në komunën e Rahovecit 16.747euro janë mjete të cilat janë ndërprerë kontratat me operatorët për shkak të shumë arsyeve të ndryshme, me çrast këto mjete kanë ngeluar dhe kemi menduar për ridestininim. Kjo pikë e rendit të ditës duhet të votohet sepse kemi të bëjmë me 175.000euro, mjete të cilat rrezikojnë të shkojnë në suficit.

**Burim Krasniqi** – Mjetet që mbesin për ridestininim është diçka normale, proces që duhet bërë. E kam një pyetje kështu dhe lidhet me drejtorinë e arsimit. Së fundmi keni lidhë kontratë për furnizim me lëndë djegëse, mjetet e planifikuar a e mbulojnë kontratën e lidhur për lëndë djegëse?... Nëse jo, atëherë ridestininimi është mirë të parashihet që ta mbulojë këtë kontratë për lëndë djegëse dhe mos të na përsëritet situata e vitit të kaluar ku kanë patur shumë shkolla vështirësi në furnizim dhe më pas i lëshohemi me kritika drejtorit të arsimit se ku janë lëndët djegëse, defakto fajet i ka drejtori i financave që nuk ia ka paraparë buxhetin për shkak të ndryshimeve në çmim të furnizimeve që kanë ndodhur. Në këtë ridestininim, shikojeni mundësinë që një pjesë të mjeteve t'i bartni për mbulim të kontratës me furnizim me lëndë djegëse. Shpresoj që mirëkuptohem edhe nga anëtarët e KPF-së, nga asambleistat në seancën e rregullt por edhe me juve si drejtor dhe ekzekutiv, që të vie me ndryshim dhe patjetër një pjesë e këtyre mjeteve të barten për furnizim të lëndëve djegëse në shkollat e komunës së Rahovecit.

**Afrim Limani** – Burim, faleminderit për pyetjen, e konsideroj si propozim me vend. Para se ta përgatisim këtë dokument ne e kemi bërë një analizë të mirë të buxhetit në raport me vlerat e kontratave dhe konsideroj që këtë mjete janë shpërndarë në mënyrë adekuate dhe në vend të qëlluar. Sa i përket pyetjes tëndë që të ridestinohen në kontratën për furnizim me lëndë djegëse. Në kuadër të kësaj kontrate kemi buxhet të mjaftueshëm dhe këtu ta

“heku merakun”, bile çdo fundvit kemi problem me shkolla të cilat rrezikojnë që mjetet e tyre të shkojnë në suficit në kategorinë mallra dhe shërbime.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor. Dikush ndonjë gjë tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për aprovimin e kësaj pike?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 4-të e rendit të ditës.

#### **5. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e projekt planit për trashëgimi kulturore 2022-2025;**

**Afrim Dina**- Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së. Para juve keni draft propozimin për planin për trashëgimi kulturore në komunën tonë siç po e shihni në projektor. Grupi punues i formuar nga kryetari i komunës me datë 01.08 kanë filluar punimet për planin e trashëgimisë kulturore, gjithashtu janë kryer të gjitha procedurat ligjore për konsultimin publik i cili ka dalur më 18.08 dhe ka përfunduar më 19 shtator. Gjithashtu është mbajtur edhe një konsultim një debat publik me qytetarë këtu në sallën e kuvendit me datë 06 nëntor ku edhe janë marrur propozimet e që më pas janë implementuar në këtë plan. Rreth punës të cilën e ka bërë grupi punues në këtë draft; kanë qenë analizat në terren (SWOT analiza) i keni në faqen 12, janë të paraqitura dobësitë që i kemi te objektet apo monumentet kulturore në komunën tonë që kërkojnë mirëmbajtje dhe trajtim. Këtu janë synimet dhe mundësitë që i jep komuna jonë në gjithë territorin e saj. Materialin iu kemi dërguar, besoj që e keni analizuar. Qëllimi kryesor i këtij plani 2022-2025 është që t'i ruajmë sa më shumë monumentet ekzistuese, monumentet tjera që duhet t'i gjejmë, një pjesë të madhe e ka gjetur grupi punues. Në shtator çdo vit e bëjmë kërkesën në qendrën rajonale në Prizren që këto monumente t'i fusim në trashëgiminë e mbrojtjes. Materialin e kemi bukur voluminoz, nuk dua të iu marr më tepër kohë.

**Burim Krasniqi** – Drejtor, po bëhem pak lokalist kësaj radhe. Fjala është për Xërxë; Stacioni i trenit është i vitit 1962, me këtë stacion dhe me infrastrukturën hekurudhore komplet menaxhon Infrakosi, konsideroj që nëse dëshirojmë ta ruajmë në të ardhmen duhet t'i drejtohem Infrakosit që mos të ndërtohet, por të mirëmbahet duke e ruajtur pamjen që e ka. Prej kureshtjes po pyes; Xhamia e Xërxës, cili është viti i ndërtimit, a keni informacion?... dhe a ka pjesë të tjera që hyjnë në trashëgimi kulturore në Xërxë?...

**Afrim Dina** – Faleminderit Burim. Grupi punues ka dalur në fshatin Xërxë, ka kontaktuar me kryetarin e fshatit dhe disa banorë aty, pjesa e stacionit të trenit do të shohim se çka do të ndodh aty në çoftëse parashihet të ruhet atëherë duhet të jetë pjesë e jona. Për xhaminë e fshatit, fatkeqësisht me hoxhën nuk kemi pas mundësi të jemi në kontakt për të marrur të dhënat e sakta, por në bazë të dhënave që i kemi me kryetarin e fshatit por edhe ish kryetarin, na kanë dhënë të dhënë që është bukur e vjetër por më hollësisht duhet të presim edhe pak të marrim datën dhe vitin e saktë dhe ta dërgojmë në qendrën rajonale.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, dikush tjetër?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për aprovimin e kësaj pike?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës.

#### **6. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;**

**Afrim Limani** – Sipas ligjit 06/ L-005 mbi tatimin në pronën e lejueshme, të gjitha kuvendet komunale janë të detyruara që ta votojnë normën tatimore. Sa për informimin tuaj kufijtë minimal dhe maksimal të normave tatimore janë nga 0.16% deri në 1%. Në nivel të republikës së Kosovës, komuna jonë i ka normat më të ulëta.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, a ka dikush prej anëtarëve të komitetit ndonjë diskutim?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 6-të.

#### **7. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2027;**

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët të KPF-së. Këtu ka qenë një gabim teknik ose nuk e di aryen që MAPL nuk e ka llogaritur për 5 vite këtë plan por e ka llogaritur për 4. Dallimi është 2022-2027, plani i dërguar nga ne ka qenë 2022-2026, këtu është dallimi i gjithë kësaj filozofie dhe duhet ta vendosim edhe një herë në kuvend për miratim.

**Kryesuesi** – Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi që e kemi marrë me datën 23 shtator 2022. Ndonjë koment lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

#### **8. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e programit komunal tre vjeçar për banim 2022 – 2025;**

**Nënkryetari** – Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, gjithë të pranishëm. Është plotësisht nejtë si te plani menaxhimit të mbeturinave, problemi qëndron te vitet, ka qenë 2022-2024 tani duhet të parashihet 2022-2025 plani i banimit 3 vjeçar sepse fillon së zbatuari në vitin 2023. Këtu parashihet në pikën 4 d.m.th që vendimi i kaluar shfuqizohet dhe prapë në seancën e kuvendit do t'i kemi këto dy plane.

**Kryesuesi** – Faleminderit nënkryetar, dikush prej anëtarëve të komitetit ndonjë koment?... Atëher po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 8-të e rendit të ditës.

#### **9. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar – shtator 2022;**

**Afrim Limani** – Raporti financiar 9 mujor është i përbërë nga 3 pjesë; Pjesa e analizimit të të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit si dhe pjesa e zhvillimit të kontratave në kuadër të zyrës së prokurimit. Çdo ngjarje mbrenda këtyre muajve janë të përfshira në kuadër të këtij raporti. Të hyrat deri në këtë periudhë në total janë; 929.072euro, nëse bëjmë një krahasim me periudhën e nejtë me vitin e kaluar, kemi një rritje prej 5681euro. Muaji shtator ka qenë një ndër muajt më të varfër sa i përket inkasimit rë të hyrave sepse ka reflektuar greva e mbajtur nga sindikata e shërbyesve civil. Ju rikujtoj që ende nuk e kemi raportin 3 mujor nga gjobat e gjykatave të trafikut, për këtë arsye e kemi një ndryshim negativ apo një zvogëlim prej 64.000euro që në këtë rast i kemi 1.1 milion bashkë me 3 mujorin e parë të këtij viti inkasim të të hyrave. Konsideroj që raporti do të na vjen shumë shpejtë dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e nejtë të vitit të kaluar kemi një rritje të të hyrave. Te shpenzimi i buxhetit; në total është 11.111.000euro ose 67.65%. Mallra dhe shërbime 70.30%, komunalitë 79%, subvencionet 80%, shpenzimet kapitale 71.06%, pagat 63.76% dhe në fund e kemi raportin nga zyra e prokurimit me të gjitha ngjarjet apo kontratat të cilat janë kontraktuar nga janari deri në shtator të këtij viti.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, a ka dikush ndonjë koment për këtë pikë të rendit të ditës?... Atëher po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 9-të e rendit të ditës.

#### **10. Informatë për përgatitjen e vitit shkollor nga DKA-ja 2022/2023;**

**Avni Morina** – I nderuar kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së, të nderuar drejtorë, drejtoreshë. Në këtë informatë jemi munduar të pasqyrojmë fillimit e aktivitetit që e kemi ndërmarrur për fillimin e vitit të ri shkollor 2022-2023. I kam pasqyruar të gjitha aktivitetet e muajit të fundit dhe fillimit që parashihet në shtator. Informatën e keni të shkruar, nëse doni edhe ua lexoj. Të gjithë e dijmë që mësimi nuk ka filluar me kohë sikur në vitet e kaluara, vitin e kaluar ka qenë pandemia, sivjet ishte greva. E kam përmendur çështjen e furnizimit me libra, vonesat, punimet e vonuar të efikasitetit në disa shkolla. Kjo është informatë dhe nuk është raport, në mbledhjen e kuvendit do t'a plotësoj edhe me informata të tjera, sepse ndërkohë pas datës që iu kam dërguar këtë informatë në emailat e juaj, kanë ndodhur edhe zhvillimet tjera si psh; furnizimi me lëndë djegëse, deri sot janë furnizuar gjysma e shkollave me dru dhe pelet.

**Besmire Bytyqi** – Faleminderit për informatën drejtor. Nëse nuk jam gabim, para dy mbledhje të KPF-së kam bërë kërkesë për shqyrtimin e orarit të punës në qerdhe, sidomos orari kur qerdhja mbaron punën. Nëse ka mundësi për mbledhjen e kuvendit ta kemi një informatë sesa është e aplikueshme dhe çfarë hapa mund të merrni si drejtori.

#### **11. Shqyrtimi i Raportit të performances komunale për vitin 2021;**

**Nënkryetari** – Faleminderit kryesues, para vetes e keni raportin e performancës komunale. Është një grup pune i formuar me vendim të kryetarit të komunës. Më herët kanë qenë 17 fusha që janë raportuar me 74 tregues, tani kemi gjithsej 19 fusha të raportimit me 109 tregues, në secilën fushë e kemi përqindjen e kryerjes së punëve dhe kështu me radhë. Pa dashur ta zgjas më shumë, nëse eventualisht keni diçka për të shtuar, këtu jemi.

**Kryesuesi** – Faleminderit nënkryetar, a ka dikush ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovet edhe pika e 11-të e rendit të ditës.

## **12. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit;**

**Ruzhdi Kabashi** – Përshëndetje anëtarë të KPF-së, kryesues, nënkryetar, drejtor. Para juve po paraqes punën e njësisë së auditimit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021. Siç e keni parë edhe te materiali se gjatë periudhës raportuese e kemi pas të planifikuar dhjetë auditime dhe kemi realizuar që të gjitha auditimet që kanë qenë sipas planit. Nga këto dhjetë auditime kemi nxjerrë 40 rekomandime, 8 janë të zbatuara gjatë vitit 2021, pjesa tjetër, disa nuk janë implementuar e disa të tjera janë në proces. Gjithashtu besoj që edhe planin për implementim të rekomandimeve e keni afër, nëse keni ndonjë pyetje, urdhëroni.

**Burim Krasniqi** – Përshëndetje, faleminderit për raportin, por unë konsideroj që ky raport me dhjetë drejtori ose njësi të audituara duhet me qenë një pasqyrë e auditimeve, prezantim i të gjeturave dhe rekomandimeve, këtu është vetëm një informatë e shkurtër mbi punën që është bërë, por nuk kemi asgjë se a ka të gjetura – rekomandime apo jo, cilat kanë qenë rekomandimet e vitit të kaluar, sa janë zbatuar ato, sa kanë mbetur këtë vit?... Besoj që kur të thuhet “raport” duhet të përfshihen edhe të gjeturat, rekomandimet, që ndërlidhen më pas me planin që e bën ekzekutivi për implementimin e tyre që i ka dhënë njësia e auditimit të brendshëm të komunës së Rahovecit. Konsideroj që në seancë duhet të jetë i kompletuar me pjesën tjetër si raport i auditorit, ose me qenë informatë e shkurtër është diçka tjetër.

**Ruzhdi Kabashi** - Faleminderit Burim. Ne si njësi e auditimit i raportojmë drejtpërdrejt vetëm krytarit të komunës, këtu kemi ardhë ta bëjmë një paraqitje ose të japim një informacion të përgjithshëm. Nëse këtë kërkesën e juaj e vendos kryetari si diskutim raportin në detaje, ajo është çështje e kryetarit, nuk është çështje që mund të vendosim ne si njësi e auditimit.

**Burim Krasniqi** – Meqenëse është në dorën e kryetarit, konsideroj që është mirë ta shtyejmë për një seancë tjetër dhe ta jep informatën kryetari ose le të ndërrohet të bëhet “informatë rreth auditimit” jo raport, fjala raport është shumë ndryshe prej asaj që është përshkruar sepse këtu thuhet vetëm çka ka bërë auditorë, asnjë pjesë të brendshme të saj.

**Nënkryetari** – Këtë raport të auditorit të brendshëm e kemi sa për performancë, ashtu e kërkon performanca dhe ne si ekzekutiv patjetër duhet ta paraqesim para anëtarëve të KPF-së dhe tutje para kuvendit. Besoj që sido që ne e quajmë meqenëse kjo është informatë por mund të bëhet edhe raport, auditori i kryen auditimet në bazë të planit vjetor të punës që e ka në secilën drejtori dhe jep rekomandimet e veta, pastaj mbi bazën e rekomandimeve në cilëndo drejtori që auditori i brendshëm në këtë rast Ruzhdia që auditon dhe i jep rekomandimet, pastaj drejtorja përkatëse është e obliguar ta bëjë një plan për zbatim të këtyre rekomandimeve dhe në fundvit shikohet ku jemi, tek jemi. Mundeni me ardhë te unë dhe te cilido drejtor të diskutojmë për çdo gjë rreth kësaj.

**Kryesuesi** – Faleminderit nënkryetar. Meqenëse ky raportim duhet të bëhet për shkak të grantit të performancës, besoj që është arsyeshme të marrim parasysh ndonjë kërkesë eventuale që mund të jetë për informata shtesë.

**Burim Krasniqi** – Nënkryetar, unë nuk kam asnjë dilem që nuk ka diçka për të fshehur, sepse nëse ka diçka të tillë janë organet përgjegjëse që merren me atë punë, nuk jemi ne për hetime dhe nuk i jap përgjegjësi dhe të drejtë vetes ta luaj rolin e hetuesit. E dyta, ne jemi për mbështetje të performancës së komunës prej asaj që del prej asamblesë komunale, po flas gjithmonë si anëtarë i KPF-së dhe si shef i grupit të asambleistave të LDK-së. Është pak nënqumuese për asamblenë nëse ia bjen dy faqe, i thua nuk ke nevoj të jesh në dijeni asgjë sepse nuk dua të të informoj në plotni asgjë, por votoje ti sepse neve na duhet për grant të performancës. Një dokument që është edhe publik e nuk është sekret është e paarsyeshme që në këtë raport të mos jetë një raportim që ta kenë asambleistat përpara ta diskutojnë i cili e vendos mirë komunën dhe asamblenë komunale për punën që e bën. Nuk dua të

Paragjykoj asgjë, absolutisht nuk jam duke e luajtur rolin e hetuesit por besoj që është e udhës që asambleistët të jenë të informuar mbi të gjeturat e auditorit sepse edhe me ligj ne si asamble e luajmë rolin e monitoruesit të komunës në kuptimin e funksionimit jo të “policit”.


**Ruzhdi Kabashi** – Sa i përket formës së raportimit në bazë të ligjit nr. 06-L-021 për kontrollën e brendshme të financave publike, neni 21; pavarësia funksionale e njësisë së auditimit të brendshëm ku pika 1 e këtij neni thotë; “Njësia e auditimit të brendshëm ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe e njofton komitetin e auditimit.”

### 13. Të ndryshme;

**Kryesuesi** – Nëse dikush prej anëtarëve të komitetit ka ndonjë propozim apo ndonjë çështje për diskutim?... Nëse jo, atëherë këtu po e përmbylлим mbledhjen e 9-të të rregullt të KPF-së, deri në seancën e radhës, mirëmbetshi.

**Mbledhja përfundoi: 10:50**

Procesmbajtësi;

  
Albion Krasniqi

